

fq. 2

Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, paraqet raportin mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2013 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2014 *fq. 2-3*
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2014 *fq. 4-5*
- » Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për vitin 2013 *fq. 5-6*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Konferenca e 6-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet (2-3 prill në Washington DC, SHBA) *fq. 7*
- » Konferenca mbi çështjet aktuale në sigurimet motorike (6-7 prill, Stamboll, Turqi) *fq. 8-9*
- » Seminar mbi abuzimet në treg dhe teknikat e investigimit efektiv ndaj tyre (15-17 prill, Varshavë, Poloni) *fq. 9-10*

LAJMET NGA RAJONI

FORUMI NDËRKOMBËTAR I SIGURIMEVE 2014

- » Prezantohet Raporti "Sigurimi Motorik 2013" *fq. 10*
- » Rusi-zhvillimet e tregut të MTPL-së prezantohen në forum *fq. 10-11*
- » Turqi-konkurrencë e fortë në tregun e MTPL-së *fq. 11*
- » Çeki » Hungari » Kroaci » Qipro » Slloveni *fq. 12-13*

STUDIME DHE BOTIME

- » Banka Botërore publikon Raportin "Piramida e Përmbysur": Sistemet e Pensioneve në Evropë dhe Azinë Qendrore përballen me sfida demografike *fq. 14*

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, paraqet raportin mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2013 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, paraqiti më 9 prill 2014 në Komisionin e Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, raportin mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së gjatë vitit 2013.

Në fjalën e saj, Znj. Shehi u përqendrua në dy drejtime kryesore: stabilizimin dhe nxitjen e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve, letrave me vlerë dhe fondeve të pensioneve private dhe vullnetare, si tregje financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Në raportim u evidentuan prirja për zgjerim që këto tregje kanë pasur edhe gjatë vitit 2013 dhe u theksua tendenca për ndryshime strukturore në tregjet financiare që AMF mbikëqyr, ku peshën kryesore tashmë e kanë fondet e investimeve dhe jo më tregu i sigurimeve.

Znj. Shehi e cilësoi si mjaft të rëndësishëm zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së, në përballimin e sfidave që sjell zhvillimi dinamik dhe struktura komplekse e tregjeve që AMF mbikëqyr, theksuar kjo dhe në rekomandimet e FSAP.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë e vlerësoi pozitivisht punën e AMF-së, të orientuar drejt nxitjes së qëndrueshmërisë së tregjeve financiare dhe forcimit të transparencës, duke u orientuar në objektiva të mirëpërcaktuara, në linjë dhe me rekomandimet e BB dhe FMN, në kuadrin e FSAP.

Për të lexuar fjalën e plotë të mbajtur nga Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë klikoni këtu <http://amf.gov.al/files/File/Raportimi%20ne%20Kuvend%20prill%202014.pdf>

Znj. Shehi e cilësoi si mjaft të rëndësishëm zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së, në përballimin e sfidave që sjell zhvillimi dinamik dhe struktura komplekse e tregjeve që AMF mbikëqyr, theksuar kjo dhe në rekomandimet e FSAP.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 26.61% gjatë periudhës janar-mars 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 2.64 miliardë lekë. Kjo u shoqërua edhe me ulje të numrit të policave të sigurimit me rreth 12.08% duke arritur në 204,660 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut janë dëmet e paguara bruto. Gjatë periudhës janar-mars 2014 dëmet e paguara bruto u ulën me 0.12% në krahasim me periudhën janar-mars 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.48 miliardë lekë, apo 79.92% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

SIGURIMI I JO-JETËS

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 29.14% gjatë periudhës janar-mars 2014, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 1.33 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2014, duke shënuar një rritje prej 29.72% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-mars 2014 zuri 50.63% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës.

KLASA TË TJERA NË SIGURIMET E JO-JETËS

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 21.16% të tregut të Jo-Jetës;
- » *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme*, të cilat së bashku zunë 12.40% të tregut të Jo-Jetës.

SIGURIMI I JETËS

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 7.11% krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 47.77% të sigurimit të Jetës.

NDARJA E TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR-MARS 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2014

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2014 u dominua në masën 84.79% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*). Pjesa tjetër, prej 15.21%, ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 94% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2014 flasin për një dominim të transaksioneve “*Blerje në tregun primar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me 64.70% dhe 20.42% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 96.64% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë 2014



*

- A - Blerje në tregun primar
- B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosije e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “*Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar*” gjatë periudhës janar-mars 2014, ka pasur një ulje në vlerë prej 9 milionë lekë ose 0.55% krahasuar me periudhën janar-mars 2013. Kjo është shoqëruar edhe me ulje të numrit të transaksioneve në masën 6.61%.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2014 flasin për një dominim të transaksioneve

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë periudhës janar-mars 2014, ka pasur një ulje në vlerë prej 137 milionë lekë ose 21.14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë numri i transaksioneve është i njëjtë me atë të periudhës janar-mars 2013.

Krahasuar me periudhën janar-mars 2013, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth **146.07** milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2013	2014	'14/'13-1
janar-mars			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	1,606.69	1,597.80	(0.55)
<i>Individë</i>	1,566.84	1,480.45	(5.51)
<i>Persona juridike</i>	39.85	117.35	194.49
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	649.06	511.88	(21.14)
<i>Individë</i>	449.06	404.02	(10.03)
<i>Persona juridike</i>	200	107.86	(46.07)

Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për vitin 2013

Gjatë vitit 2013 në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2013 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 436.03 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 152.44 milionë lekë (53.75%). E shprehur në euro (Kursi zyrtar i këmbimit më 31.12.2013 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 140.2 lekë, www.bankofalbania.org) totali i aseteve nën menaxhim është 3.11 milionë euro.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve në fund të vitit 2013 ishte 7,887 anëtarë duke shënuar rritje prej 8.32% krahasuar me fundin e vitit 2012.

Tregues të fondeve të pensioneve

(31.12.2013)


Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
	2012	2013	
Asetet neto të FP	283.01	434.82	53.64

Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve


(31.12.2013)

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	3,503	202.19
RAIFFEISEN	2,548	174.49
SICRED PENSION	1,836	58.14
TOTAL	7,887	434.82

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.12.2013 (në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 31.12.2013 (në %)



ZHVILLIME TË TJERA

Konferenca e 6-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet

Gjatë datave 2-3 prill në Washington DC, SHBA, Banka Botërore zhvilloi Konferencën e 6-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet dhe në vazhdim seminarin mbi strategjinë e mbikëqyrjes dhe rregullimit në sistemin e pensioneve.

Konferenca mbledhi mbi 150 pjesëmarrës nga autoritet rregullatore dhe mbikëqyrësit e tregut të pensioneve, si edhe drejtues të kompanive të sigurimit të Jetës, akademikë, zyrtarë nga organizatat financiare ndërkombëtare, të Grupit të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Konferenca e 6-të ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet u fokusua në mësimet e nxjerra gjatë 20 viteve të fundit në analizimin dhe zbatimin e politikave në sistemin e pensioneve. Programi i konferencës synonte shkëmbimin e eksperiencave mbarë-botërore në gjetjen e mjeteve, teknikave si dhe zbatimin e politikave të dobishme për të përmirësuar rezultatet e punës në sistemin e pensioneve në dekadat e ardhshme. Aty u paraqitën rezultatet e punës së mbështetur nga Grupi i Bankës Botërore i ngritur për të ndihmuar vendet në zhvillimin e sisteme efektive mbikëqyrëse, për të lehtësuar reformën e sistemit të pensioneve dhe adresimin e problemeve që ndeshen në ecurinë e mëtejshme të tregut të pensioneve në vendet në zhvillim.

Në sesione të veçanta u trajtuan:

- » Qëndrueshmëria dhe problematikat lidhur me plakjen e popullsisë;
- » Sfidat dhe risitë në zgjerimin e mbulimit me skema pensioni;
- » Refleksionet rajonale dhe globale të skemave të ndryshme;
- » Tendencat botërore të investimeve, investitorët institucionalë dhe infrastruktura, sidomos në tregjet në lindje;
- » Struktura e tregut, shkalla dhe drejtimi si forca udhëheqëse për përmirësimin e kostove dhe investimeve.

Vende të ndryshme evropiane si Greqia, Italia, Polonia, Suedia sollën eksperiencat e tyre se si po përballen ato me ndryshimet në sistemin e pensioneve. Po kështu eksperiencia u sollën edhe nga Azia Qendrore, Amerika Latine, India, etj. Konferenca dha një kontribut të rëndësishëm edhe në hartimin e platformave sa më mira që pensionet publike dhe private të mund të ndihmojnë për të lehtësuar vështirësitë ekonomikë të vendeve.

Në vazhdim, u zhvillua një tryezë e përbashkët diskutimi mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen në sistemin e pensioneve. Në diskutime u theksua nevoja për mbikëqyrjen me bazë riskun, si pjesë e procesit të reformës strategjike. Midis diskutimeve nga vende të ndryshme, u prezantua edhe eksperiencia dhe zhvillimet e fundit në sistemin e pensioneve, dhe veçanërisht në kolonën e tretë, të Shqipërisë. Gjithashtu, u shkëmbyen informacione për projektet e zhvilluara dhe ato në vazhdim, duke përfshirë bazën e dhënave, infrastrukturën e pagesave, etj.

Konferenca mbi çështjet aktuale në sigurimet motorike

Gjatë datave 6-7 prill 2014, në Stamboll, Turqi, u zhvillua Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve me temë “Sigurimi motorik-rruga drejt rentabilitetit”. Inteligjenca dhe teknologjia në shërbim të rentabilitetit”. Në konferencë merrnin pjesë mbi 70 ekspertë të tregut të sigurimeve, përfaqësues të byrove kombëtare të sigurimeve, shoqatave të siguruesve nga 17 vende të Evropës.



Gjatë punimeve të konferencës mbi çështjet aktuale në sigurimet motorike, Stamboll, Turqi

Presidenti i Këshillit të Byrove (*The Council of Bureaux, CoB*) Z. Mariusz Wichtowski ishte ndër folësit kryesorë në këtë forum.

Këshilli i Byrove është një organizatë që koordinon Byrotë Kombëtare të vendeve të ndryshme të cilat marrin pjesë në sistemin e Kartonit Jeshil. Ky Këshill shërben edhe si sekretariat dhe është aktiv lidhur me Fondin e Garancisë për të gjitha vendet ku zbatohen direktivat e Bashkimit Evropian mbi sigurimin motorik (*EU motor insurance Directive*).

Presidenti i Këshillit të Byrove, Z. Mariusz Wichtowski theksoi se mjaft nga problemet aktuale të lidhura me sigurimin motorik në Evropë janë të lidhura me aspektet financiare. Ai bëri edhe një pasqyrë të gjerë të problematikave me të cilat lidhet sot mbrojtja e konsumatorëve në sigurimet motorike.

Një seksion i veçantë i konferencës ju kushtua problematikave të sigurimit motorik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ndër tematika që u trajtuan në këtë seksion ishin:

- » Rentabiliteti i industrisë së sigurimeve, shqetësimi kryesor në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore;
- » Liberalizimi i çmimeve MTPL, një prag për tu kaluar;
- » Sigurimi Kasko, a është ky një treg që po zvogëlohet;
- » Roli i teknologjisë në sigurimet motorike, çmimet dhe zgjidhjet për çmime të ndershme të sigurimeve motorike.

Në seksionin e drejtuar nga Znj. Menekshe Ucaroglu, Presidente e Bordit të Marrjes në Sigurim të Stambollit (*Istanbul Underwriting Centre, IUC*) u trajtuan ndër të tjera edhe problematikat që lidhen me kompensimin për lëndimet trupore në aksidentet motorike dhe dallimi midis pagesave të dëmeve të drejta dhe të arsyeshme.

Në seksione të tjera u diskutua mbi teknikat për të luftuar mashtrimet në sigurime dhe bashkëpunimi ndërkufitar, si një hap i rëndësishëm për një treg pa manipulime. Këto tematika u trajtuan edhe me raste studimore nga pjesëmarrësit në konferencë.

Seminar mbi abuzimet në treg dhe teknikat e investigimit efektiv ndaj tyre



Gjatë zhvillimit të seminarit mbi abuzimet në treg dhe teknikat e investigimit efektiv ndaj tyre, Varshavë, Poloni

Iniciativa Trajnuese për Mbikëqyrësit Financiarë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, AMFP, zhvilloi në datat 15-17 prill 2014, në Varshavë, Poloni, seminarin me temë “Abuzimet e tregut dhe teknikat e investigimit efektiv ndaj tyre”.

Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të autoriteteve rregullatore të vendeve të ndryshme të Evropës Lindore dhe Qendrore, të cilët ndanë shembuj të praktikave dhe standardet më të mira mbikëqyrëse të vendeve të tyre.

Përfaqësues të Departamentit Ligjor të Autoritetit Polonisë, AMFP, paraqitën shembuj konkretë nga praktika e tyre e përditshme, lidhur me raste abuzive dhe manipulimet me tregun e kapitaleve, teknikat investiguese, sistemet elektronike të informacionit që ata përdorin për mbikëqyrjen e tyre. U prezantua marrja e masave rregullatore në mbrojtje të interesave të investorëve.

Çështjet kryesore që u trajtuan në këtë seminar kishin të bënin kryesisht me:

- » Ndikimin e abuzimit në treg në integritetin e tregjeve financiare;
- » Kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian mbi “tregtuesit e brendshëm” dhe manipulimin e tregut të kapitaleve;

- » Aftësinë për të përdorur zhvillimet teorike dhe praktikën kur është fjala për të bërë dallimin midis abuzimit në treg nga sjellja e ligjshme;
- » Teknikat investiguese dhe sfidat e shpeshta me të cilat përballet lufta kundër abuzimit në treg;
- » Efektiviteti i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër abuzimeve të tregut.

Seminari u fokusua në sfidat me të cilat përballen autoritetet rregullatore në drejtim të efektivitetit të luftës kundër abuzimeve të tregtuesve të brendshëm të letrave me vlerë dhe manipulimeve të tregut të kapitaleve. Kjo është shumë e rëndësishme të kuptohet, pasi këto shkelje influencojnë drejtpërdrejtë në transparencën e këtij tregu dhe ekonominë reale.

LAJMET NGA RAJONI

Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve 2014

Konferenca e 6-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet

www.xprimm.com

Gjatë Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve 2014 u prezantua zyrtarisht numri i dytë i revistës raporti “Sigurimi Motorik 2013”. Revista përfshin të dhëna financiare për 32 vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, SEE dhe CIS, të përditësuara për vitin 2013.

Raporti “Sigurimi Motorik 2013” mbulon një shumëllojshmëri të gjerë të informacionit në lidhje me segmentin e sigurimit motorik, si dhe të dhënat lidhur me fusha të ngjashme: të situatës ekonomike të tregjeve të analizuar në Raport, statistikat në lidhje me parqet kombëtare të makinave dhe rrugëve, shpeshtësinë dhe shkaqet kryesore të aksidenteve motorike, marrjen në sigurim, dëmet e paguara dhe çështjet kryesore të segmentit të sigurimit motorik për secilin vend, të analizuar.

Në të njëjtën kohë, revista pasqyron tarifat e sigurimeve për vende të ndryshme evropiane në segmentin Kasko dhe MTPL.

Rusi - zhvillimet e tregut të MTPL-së prezantohen në forum

www.xprimm.com

Gjatë Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve 2014, President i Shoqatës ruse të sigurimeve motorike, Pavel Bunin deklaroi gjatë se volumi i primeve të shkruara bruto nga shoqëritë e sigurimeve ruse në segmentin e TPL-së së brendshme për vitin 2013, arriti rreth 135.1

miliard RUB (monedha vendase Rubla Ruse). Në të njëjtën kohë dëmet e paguara arritën 78.1 miliard RUB. Sipas Bunin, "segment MTPL ishte motori i sigurimit rus tregut. Rreth 2,7 milion njerëz morën kompensime".

Lidhur me tendencat e fundit në treg, ai theksoi se në vitin 2009 u prezantua në treg sistemi i drejtpërdrejtë i kompensimit, MTPL. Nëpërmjet këtij sistemi, pala e dëmtuar mund të kërkojë dëmshpërblim nga kompania e saj, për sigurimin TPL e brendshme. Më pas, kompania mbulon shumën nga siguruesi TPL në palën fajtoare.

Sistemi ka funksionuar mjaft mirë, "në këtë mënyrë, në vitin 2013 dëmet e paguara përmes sistemit të drejtpërdrejtë të kompensimit arritën në 29% të totalit të dëmeve të paguara të MTPL, duke u rritur me 26% krahasuar me vitin 2012", shtoi Pavel Bunin.

Përsa i përket projekteve aktuale sipas Pavel Bunin, autoritetet po punojnë për lëshimin elektronik të policave të sigurimit TPL, i cili do të zbatohet në 3-5 vitet e ardhshme.

Turqi - konkurrencë e fortë në tregun e MTPL-së

www.xprimm.com

Gjatë Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve 2014, Alper Tan, Drejtori i Shoqatës së Sigurimit, Risigurimit dhe Pensioneve të Turqisë u shpreh për xprimm se "Ekziston ende një konkurrencë e ashpër për nivelin e çmimeve dhe kjo situatë çon në një "luftë" në mes siguruesve për të mbajtur pozicione dominuese në treg, duke vendosur si kriter vëllimin e primeve të shkruara bruto. Prandaj, këtë vit ne nuk presim që fitimi të jetë objektivi kryesor i tregut të sigurimeve motorike" shpjegoi ai.

Si një formë zgjidhjeje në këtë drejtim, autoritetet turke kanë për qëllim të zbatojnë kompensimin e drejtpërdrejtë, në mënyrë që zotëruesit e policave MTPL të jenë në gjendje të marrë kompensime të drejtpërdrejta nga siguruesit e tyre. "Ne besojmë se kompensimi i drejtpërdrejtë do të zvogëlojë luftën e çmimeve.

"Ne nuk mund të themi se cila zgjidhje është më e mirë, por duke marrë parasysh veçantitë e çdo vendi, ne morëm në konsideratë kompensimin e drejtpërdrejtë," theksoi Alper TAN. "Metoda e drejtpërdrejtë e kompensimit paraqet disa vështirësi, sepse siguruesi mund të përpiqet që për të zvogëluar shpenzimet, të kërkojë pjesë me cilësi të dobët për servis dhe për këtë arsye, ne duhet të marrim në konsideratë edhe marrjen e vërtetimeve nga pikat e shërbimit," përfundoi Alper TAN.

Tregu i sigurimeve në Çeki e përfundoi vitin 2013 me një rritje modeste të primeve të shkruara bruto me prej 1.9% krahasuar me vitin 2012. Volumi total i primeve të shkruara bruto arriti në 156.5 miliardë CZK (monedha vendase korona çeke). Megjithatë, e konvertuar në monedhën euro, pas zhvlerësimit rreth 9% të monedhës Çeke gjatë 12 muajve të fundit, rezultatet e përgjithshme të tregut të sigurimeve, tregojnë një ndryshim negativ prej 6.6% në krahasim me vitin 2012 dhe një shumë të përgjithshme të primeve të shkruara bruto prej 5.7 miliardë euro.

Segmenti i sigurimit të Jetës ka shënuar një tendencë negative. Në sigurimet e Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në 84.95 miliard CZK (rreth 3.1 miliardë euro), duke shënuar një rritje prej 4.16% në monedhën vendase ose rënie e vlerësuar në euro. Sigurimi i kredisë, me një rritje prej 22.15% ishte klasa që tregoi dinamikën më të mirë. Megjithatë, për shkak të peshës së saj shumë të ulët në portofolin e tregut, kontributi i tij në dinamikën e tregut mbeti mjaft i vogël.

Në sigurimin motorik, primet e shkruara bruto të MTPL-së u rritën me 7%. Ndërsa sigurimi Kasko pati një rritje të qëndrueshme në monedhën vendase ku vlera e primeve të shkruara bruto arriti në 14.5 miliardë CZK (me ulje prej 8.5% për rezultat të zhvlerësimit të monedhës në raport me euron).

Segmenti i sigurimit të pronës, në fund të vitit 2013 regjistroi një rritje me 2.8% të primeve të shkruara bruto (e shprehur në monedhën vendase CZK).

Dëmet e paguara u rritën me 14% në krahasim me vitin e mëparshëm, kryesisht për shkak të rritjes rreth 75% të dëmeve të paguara për sigurimin e zjarrit dhe më tej përmbytjet ekstreme të verës 2013.

Për herë të parë në pesë vitet e fundit, tregu hungarez i sigurimeve e mbylli vitin me një ndryshim pozitiv në rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto, (pavarësisht monedhës në të cilën bëhet llogaritja). Në fund të vitit 2013, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në 2.7 miliardë euro rreth 3.35% më shumë në krahasim me një vit përpara. Dëmet e paguara ranë me 3.3% duke arritur në 1.89 miliard euro.

Segmenti i sigurimit të Jetës regjistron dinamikën më të mirë, me rritje prej 6.25% më shumë në krahasim me vitin e mëparshëm (e shprehur në euro), duke rritur peshën e saj në portofolin e tregut.

Në segmentin e Jo-Jetës, sigurimi motorik vazhdoi të ketë performancë të dobët, duke regjistruar rënie të volumit të primeve të shkruara bruto, në krahasim me një vit më parë, si në monedhën vendase dhe evropiane. Megjithatë, ecuria pozitive e klasave të tjera, veçanërisht e klasave të sigurimit të pronës, çuan që rezultatet e përgjithshme të tregut të Jo-Jetës të ishin pozitive. Kështu, sigurimet e Jo-Jetës në fund të vitit 2013 patën një rritje të volumit të primeve të shkruara bruto prej 2% në monedhën vendase ose 0.08% në euro.

KROACI

www.xprimm.com

Rezultatet për tregun kroat të sigurimeve për vitin 2013 tregojnë një rritje prej 0.4% të volumit të primeve të shkruara bruto, e shprehur në monedhën vendase, por me rënie prej 0.8% e vlerësuar në euro. Kjo reflekton një gjendje stancioni në biznesin e sigurimeve atje. Volumi total i primeve të shkruara bruto arriti në 1.2 miliard euro, nga të cilat 28% të primeve i takojnë sigurimit të Jetës.

Sigurimi i Jetës pati një tendencë të lehtë në rritje, me një normë rritje vjetore prej gati 2%, pavarësisht rënies së vazhdueshme të marrjes në sigurim për produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me kuota në fondet e investimeve. Në klasat e sigurimeve të Jo-Jetës janë vënë re tendenca të ndryshme, me një rënie rreth 10% në sigurimin Kasko apo primeve të sigurimit në udhëtim dhe rritjen rreth 6% të primeve të shkruara bruto për GTPL ose për sigurimin “mallrat në transport”.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, volumi i primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve në vend në fund të vitit 2013 arriti në 750 milionë euro me një rënie vjetore prej 7.4%.

Në Sigurimin e Jetës, u raportua një dinamikë negative prej 9.1% në krahasim me një vit më parë duke arritur në 319 milion euro. Ndërsa në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës, ulja ishte vetëm 6% nga viti i kaluar.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve Sllovene, në fund të vitit 2013, vlera e primeve të shkruara bruto të raportuara nga kompanitë e sigurimeve sllovene, arriti në 1.98 miliard euro, me një rënie prej 3.73% në krahasim me një vit më parë. Tendencë negative u vu re në sigurimin motorik, sigurimin e pronës dhe të Jetës. Primet e sigurimit të pasurisë, të cilat përfaqësojnë rreth 12% të të gjitha primeve të shkruara bruto, ranë me 2.9% duke arritur në 230 milionë euro. Kjo ishte më tepër pasojë e rënies prej 6.2% në klasën e sigurimit të pasurisë nga dëmtimet. Për sa i përket sigurimit motorik, MTPL, u ul me 8.3% në krahasim me një vit parë ose duke arritur në rreth 242 milionë euro. Primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko arritën në 226 milionë euro, ose 5.4% më pak në krahasim me një vit më parë. Segmenti i sigurimit të Jetës është ulur me 14% dhe kjo më tepër si pasojë e rënies në klasat e produkteve të lidhur me kuota fonde investimesh.

STUDIME DHE BOTIME

Banka Botërore publikon Raportin “Piramida e Përmbysur”: Sistemet e Pensioneve në Evropë dhe Azinë Qendrore përballen me sfida demografike

Vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore po përballen me sfida të mëdha në sistemin e tyre të pensioneve, pavarësisht reformave që këto vende kanë ndërmarrë në vitet e fundit.

Raporti i ri i Bankës Botërore “Piramida e përmbysur” dokumenton sfidat e sistemit të pensioneve në këto rajone dhe analizon mundësitë e ndryshme që këto vende kanë për të përballuar këto boshllëqe në sistemin e tyre të pensioneve.

Raporti shpreh nder te tjera se një sistem më i qëndrueshëm do të kërkojë reforma në tregun e punës, përmirësime në mekanizmat e kursimeve, dhe në shumë raste burime shtesë publike. Shkalla në të cilën një vend mund të ndërmarrë reforma në tregjet e punës, kursime dhe financat publike mund të influencojnë në masën në të cilën sistemi i tij i pensioneve do të duhet të ndryshojë. Por në të gjitha rastet, ndryshimet që duhet të bëhen duhet të diskutohen gjerësisht dhe të pranohen për të parandaluar kthesat e dhimbshme e të papritura publike.

Për të lexuar të gjithë raportin klikoni në faqen zyrtare të Bankës Botërore
<http://elibrary.worldbank.org/doi/book/10.1596/978-0-8213-9908-8>